



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry Of
Internal Affairs

STRATEGJIA SHITETËRORE KUNDËR NARKOTIKËVE
DHE
PLANI I VEPRIMIT
2018 – 2022

Shkurt 2023



PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia Shtetërore Kundër Narkotikeve është dokument i cili prezanton situatën e përgjithshme, mekanizmat institucional, dobësitë e tanishme, parimet themelore në luftimin kundër narkotikeve së bashku me disa faktorë kryesor për arritje të suksesit dhe më në fund do t'i përcaktojë synimet dhe mënyrat e mundshme për arritjen e tyre. Strategjia Shtetërore Kundër Narkotikeve e Republikës së Kosovës, për periudhën 2018-2022 është vazhdimësi e strategjisë paraprake dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të narkotikeve. Ky dokument është i strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikoj qartë objektivat dhe aktivitetet që duhet të përmbushën, në mënyrë që i gjithë mekanizmi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të narkotikeve, si dhe duke qenë partner serioz me vendet tjera në përpjekjet ndërkombëtare në luftë kundër kësaj dukurie përmes bashkëpunimit ndërkombëtare. Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i mëtejshëm i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e narkotikeve.

Strategjia Shtetërore kundër Narkotikeve dhe Plani i Veprimit 2018-2022 është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2018 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021.

PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

MPB-ja, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore në realizimin e kësaj strategjie, e duke u mbështetur në planin e veprimit, pas pranimit të raporteve të rregullta nga të gjitha Institucionet ka bërë vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2022 të Strategjisë Shtetërore kundër Narkotikeve 2018-2022.

Prej periudhës së miratimit të Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës kundër Narkotikëve, është arritur përparim në përmbushjen e parametrave, objektiveve, veprimeve dhe aktiviteteve në kuadër të këtyre veprimeve, nga institucionet të përfshira në implementim.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit është shtrirë në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektiveve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit, duke vlerësuar treguesit dhe treguesit e ndërmjetëm.

Sa i përket këtij implementimit të planit të veprimit, sipas vlerësimit të aktiviteteve të cilat janë përmbushur në vitin 2022, është vlerësuar se nga 62 aktivitete të objektiveve të përgjithshme janë implementuar gjithsejtë: **plotësisht 52** pjesërisht **00**, ndërsa **10** nga aktivitetet nuk janë implementuar. Aktivitetet e pa realizuara barten në Planin Veprimit në Strategjinë e re shtetërore për vitin 2023-2028.

Përpara se të përshkruhet zbatimi i secilit objektiv, këtu mund të jepen informata përmbledhëse mbi progresin e përgjithshëm. Mund të përfshijë informacione për:

- 1) *reformat e zbatuara me sukses gjatë vitit* - Është funksionalizuar pozita e Observatorit të Drogave në kuadër të Sekretariatit të Strategjive. Kjo e arritur është vlerësuar edhe në raportin e vendit të Komisionit Evropian për vitin 2022 dhe është theksuar se është përmirësuar bashkëpunimi me EMCDDA falës mbështetjes nga ekspertiza ad hoc të Observatorit kombëtar të drogës;



- 2) *fushat që kanë nevojë për përmirësim në zbatim*- Hartimi i Udhezimit Administrativ/PSO për procesin e shkatërrimit të narkotikëve
Hartimi i regjistrit nacional i vdekshmërisë së ndërlidhur me përdorim të narkotikeve
Krijimi i bazës së të dhënave për regjistrim të personave përdorues të narkotikëve
- 3) **ekzekutimin e përgjithshëm të buxhetit.**

Objektivi Strategjik 1: REDUKTIMI I KËRKESËS DHE ZVOGËLIMI I DËMIT

Ky Objektiv Strategjik, në vete përmbanë 5 Objektiva Specifik dhe 24 Aktivitete. Duke u bazuar në raportimin e institucioneve përgjegjëse lidhur me reduktimin e kërkesës dhe zvogëlimin e demit në parandalimin dhe luftimin kundër narkotikëve, mundë të themi se nga aktivitetet e parapara, janë implementuar:

Gjithsejtë: 24

Plotësisht: 20

Pjesërisht:

Nuk janë implementuar 04

Objektivi Strategjik 2: REDUKTIMI I OFERTËS DHE FURNIZIMIT

Ky Objektiv Strategjik, në vete përmbanë 3 Objektiva Specifik dhe 24 Aktivitete. Duke u bazuar në raportimin e institucioneve përgjegjëse lidhur me reduktimin e ofertes dhe furnizimit në parandalimin dhe luftimit të narkotikëve,, mundë të themi se nga aktivitetet e parapara, janë implementuar:

Gjithsejtë: 24 aktivitete

Plotësisht: 22 aktivitete,

Pjesërisht: 00 aktivitete,

Nuk janë implementuar 2

Objektivi Strategjik 3: BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI

Ky Objektiv Strategjik, në vete përmbanë 2 Objektiva Specifik dhe 14 Aktivitete. Duke u bazuar në raportimin e institucioneve përgjegjëse lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin me qëllim të parandalimit dhe luftimit të narkotikëve, mundë të themi se nga aktivitetet e parapara, janë implementuar:

Gjithsejtë: 14 aktivitete

Plotësisht: 11 aktivitete,

Pjesërisht:00 aktivitete,

Nuk janë implementuar 3

- 1) *Vlerësimi i arritjeve kryesore, duke përdorur tregues dhe grafikë*

Është funksionalizuar pozita e Observatorit të Drogave në kuadër të Sekretariatit të Strategjive. Kjo e arritur është vlerësuar edhe në raportin e vendit të Komisionit Evropian për vitin 2022 dhe është theksuar së është përmirësuar bashkëpunimi me EMCDDA falës mbështetjes nga ekspertiza ad hoc të Observatorit kombëtar të drogës;

- Është përgatitur raporti për tregun e drogës dhe krimin për vitin 2021, i cili është dërguar në EMCDDA;



- Është përgatitur raporti për situatën me droga në vend, të cilat po ashtu janë dërguar në EMCDDA.
- 2) *historitë e suksesit gjate vitin 2022 eshte arritur sukses i madh ne luftimin e grupeve kriminale dhe konfiskimin e narkotikeve*
- 3) *vlerësimin e sfidave, mangësive dhe pengesave*
 - Ngritja e kapaciteteve tek institucionet përgjegjëse për raportim (Trajnim shtesë) dhe unifikimi i mënyrës së raportimit tek Sekretariati i Strategjive
 - Shkëmbimi i informacioneve në lidhje me abuzimin me drogë.
 - Nxitja dhe përkrahja e projekteve hulumtuese lidhur me dukurine e drogave.
 - Krijimi i bazës së të dhënave për regjistrim të personave përdorues të narkotikëve
 - Hartimi i regjistrit nacional i vdekshmërisë së ndërlidhur me përdorim të narkotikeve
- 4) *resurset buxhetore*

- 5) *konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm* Aktivitetet të cilat nuk janë implementuar në periudhen 2022 barten ne Plnin e Veprimit te Strategjise se re 2023- 2028.

RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

- Mungesa e funksionalizimit të pozitive të Koordinatorëve Nacional, e cila ka ndikuar që për disa strategji të mos mbahen takimet e rregullta dhe të ngecin disa politika dhe prioritetet.
- Numri i vogël i takimit të ekipit mbikëqyrës për zbatim te Strategjise dhe Planit të Veprimit 2018-2022;
- Mos raportimi në baza të rregullta i anëtarëve të ekipit mbikëqyrës për aktivitetet e realizuar gjatë vitit 2022;
- Mos mbështetja financiare për realizimin e disa aktiviteteve veçanërisht ne organizimin e fushatave te vetëdijesimit ku ka implikime financiare.
- Ndryshimi i anetareve te grupit mbikëqyrës ne Institucione tjera dhe mos informimi per zëvendësimin e tyre.
- Mos raportimi i anetarve te grupit mbikëqyrës ne trajnime dhe seminare jashtë vendit qe kane te bëjnë me Narkotike.



PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË SHETËRORE KUNDËR NARKOTIKËVE
2018-2022

STRATEGJIA SHETËRORE KUNDËR NARKOTIKËVE DHE PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2022								
Objektivi Strategjik 1: REDUKTIMI I KËRKESËS DHE ZVOGËLIMI I DËMIT								
Objektivi specifik 1.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2019	Caku 2022		
Parandalimi dhe edukimi	<ul style="list-style-type: none"> Vetëdijesimi dhe edukimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës lidhur me shkaktarët dhe pasojat nga përdorimi i narkotikëve. 			<ul style="list-style-type: none"> 20% 	<ul style="list-style-type: none"> 50% 	<ul style="list-style-type: none"> 80% 		
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Hartimi dhe zbatimi i kurikulumeve shkollore me qëllim të edukimit dhe vetëdijesimit të nxënësve për pasojat që sjell përdorimi i narkotikeve dhe substancave të reja psikoaktive	TM 1- 2022 TM 4-2022	3.333 €	3.333 €	3.333 €	BRK	MASHT	MPB, MSH, PK	Korikulat e hartuara dhe të zbatuara 12 programe mësimore të hartuara MASHT- te gjitha programet e hartuara dhe zbatimi I kurkulave.
2. Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve informues lidhur me shkaktarët dhe pasojat nga përdorimi i narkotikeve.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	4.166 €	4.166 €	4.166 €	BRK	KN/MPB	MSH, PK, MASHT, MKRS	Shpërndarja e materialeve indormuse në



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>100% të teritorit të Kosovës Labyrinth –1982 Broshura dhe 1693 Lifleta. MKRS- Një (1) projekt në nën-objektivën e parandalimit të drogave ilegale. Projekti mban titullin „Say NO use drugs“ i OJQ-së Institute for Social Activities. Projekti përkrahet me 5560 Eur dhe do të zbatohet në Komunën e Prizrenit dhe Dragashit. Projekti do të zgjas 3 muaj. Në projekt parashihen të përfitojnë direkt 80 të rinjë dhe 500 të tjerë indirekt përmes</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								broshurave edukative. Projekti është nga minoritetet jo shumicë boshnjak – goran.
3. Organizimi i debateve me qëllim informimi dhe vetëdijesimi për dukurinë e narkotikeve.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	333€	333€	333€	BRK	MPB, MASHT , MSH	PK, MKRS OJQ	15 debate të realizuara Labyrinth – 3 debate me nje numper total prej 24 personave.
4. Organizimi i fushatave parandaluese me qëllim te vetedisimit.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	3.333 €	3.333 €	3.333 €	BRK	MPB	MKRS, MSH , MASHT, OJ, ON	Pesë (5) Fushata të realizuara SS- janë mbajtur dy fushata gjate vitit 2021 dhe 2022
5. Hapja e WEB faqës që ka për qëllim informimin, vetëdijesimin dhe parandalimin qe ka te bëjë me Narkotikë	TM 1- 2022 TM 4- 2022	5.000 €			BRK	MPB	ARKEP, OJQ,ON	Krijimi dhe funksionalizimi i WEB faqes Ne proces te krijimit
6. Angazhimi aktiv i ish përdoruesve në programet parandaluese	TM 1- 2022 TM 4- 2022	5.600 €	5.600 €	5.600 €	BRK	LABYRINT H,MPMS,M SH	OJQ	Numri i të angazhuarve K1 Labyrinth – 8 persona. K2- Labyrinth – 7 persona.



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								K3 Labyrinth – 6 persona. K4- Labyrinth – 2 persona.
7. Organizimi i takimeve me prindër, me qëllim të informimit lidhur me rolin e tyre në fushën e parandalimit të konsumimit të Narkotikeve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	833€	833€	833€	BRK	MASHT	MPB,PK,M SH,OJQ	30 takime te bajtura K1 Labyrinth – 32 prinder dhe 18 keshillime familjare. K2- Labyrinth – 24 prinder dhe 6 keshillime familjare. K3 Labyrinth – 42 prinder dhe 21 keshillime familjare. K4 Labyrinth – 30 prinder dhe 15 keshillime familjare.
8. Trajnimi i mësimeve lidhur me identifikimin e hershëm	TM 1- 2022 TM 4- 2022	5.000 €	5.000 €	5.000 €	BRK	MASHT	MPB,PK,M SH,KP,OJQ ,ON	Numri i mësimeve të trajnuar MASHTI- Ne kuadër të trajnimit per shendetin seksual riprodhues janë trajnuar mësimeve edhe për



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								parandalimin e narkotikëve Deri me tani janë trajnuar 119 mësime dhënë Programi për parandalimin e braktisjes në shkollë që mundëson identifikimin e problemeve të ndryshme duke përfshirë dhunën dhe narkotikët.
9. Përpilimi i kurikulave për aktivitete extra kurikulare	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.666 €	1.666 €	1.666 €	BRK	MASHT	MSH,OJQ	Numri i kurikulave 1 (një) program me 3 (tre) pjesë / 1-5, 6-9, 10-12 MASHT- Aktivitetet ekstra kurikulare janë pjesë e kurikulës së re të Kosovës dhe të përfshira në lëndë mësimore si; edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, biologjia, edukatë qytetare,



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

Objektivi specifik 1.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2019	Caku 2020	
Trajtimi dhe Rehabilitimi	<ul style="list-style-type: none"> Rehabilitim I qëndrueshëm I personave perdorues te narkotikëve permes zgjerimit te sherbimeve detoksikuese, progroameve te terapise zevendsuse neper qendrat tjera regjionale duke perfshire edhe burgjet 				<ul style="list-style-type: none"> 10% 	<ul style="list-style-type: none"> 50% 	<ul style="list-style-type: none"> 90% 	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Adaptimi i hapësirave apo ndërtimi i hapësirave të reja për trajtim, rehabilitim sikur që është një qendër apo një institut të veçantë	TM 1- 2022 TM 4- 2022	66.6666€	66.6666€	66.6666€	BRK	MSH	MD, OJQ, ON	5 qendra të adaptuara dhe 1(nje) qendër e ndërtuara MSH - Vazhdimsi 4 qendra te adaptune dhe vazhdon ofrimi i shërbimeve ndërsa qendra apo instituti i vencante nuk eshte bere
2. Zgjerimi i shërbimeve detoksikuese në repartet psikiatrike të spitaleve regjionale	TM 1- 2022 TM 4- 2022	16.666 €	16.666 €	16.666 €	BRK	KN,MSH	MD,OJQ,ON	5 shëbime detoksifikuese në spitalet regjionale



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>Klinika Psikiatrike- trajtime hospitalore ne repartin per semundjet e varesise - RSV permes programit detoksikues 32 pacient - ne Trajtim Mbajtes me Metadon - TMM 18 klient (numer i bartur nga tremujori i kalum)</p> <p>Raport K2</p> <p>rajtime hospitalore ne repartin per semundjet e varesise - RSV permes programit detoksikues 37 pacient - sherbime ambulatore ne</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>Trajtim Mbajtes me Metadon - TMM 18 klient (numer i bartur nga tremujori i kalum) qe dmth nuk ka patur largime e as pranime te reja te klienteve K3Klinika e Psikiatrie Reparti i Semundjve te Varesise - RSV ka patur 31 pranime te reja per trajtim detoksikues, ne Tremujorin e trete 2022. Ndersa sherbimi ambulator i Trajtimit Mbajtes me Metadon - TMM, ka 19 klient (gjate tremujorit III, janw pranw dy klient te rinje) K4 -.- trajtime hospitalore ne repartin per semundjet e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								varesise - RSV permes programit detoksikues 37 pacient - ne Trajtim Mbajtes me Metadon - TMM 19 klient (18 te bartur nga tremujori i kaluar, nje pranim i ri)
3. Zgjerimi i ofrimit të programeve të terapisë zëvendësuese në Qendra të tjera Regjionale.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	16.666 €	16.666 €	16.666 €	BRK	MSH	MPB,ON	4 Qendra Regjionale MSH- Programi i terapisë mbajtëse me metadon zbatohet në <u>gjashhtë</u> qendra regjionale të vendit. Të gjithë klientët në të gjitha qendrat zbatuese të programit të terapisë mbajtëse me metadon kanë marrë shërbimin e duhur të terapisë mbajtëse



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								me metadon në periudhën:
4. Trajnimi i stafit për trajtim në programet detoksikuese dhe ato të zëvendësimit	TM 1- 2022 TM 4- 2022	3.333 €	3.333 €	3.333 €	BRK	MSH	ON,OJQ	Numri i stafit të trajnuar
5. Zgjerimi i programit për trajtimin e përdoruesve të narkotikëve në burgje (detoksi programet terapi zëvendësuese)	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.666 €	1.666 €	1.666 €	BRK	MSH	MD,ON,OJQ	Programi i Terapisë Mbajtëse me Metadon në Burgje përveç që është zgjeruar edhe në dy qendra korrektuese sipas planifikimit në Strategji. Ky shërbim për shkak të rrethanave, përkatësisht masave, të imponuara nga pandemia si dhe kufizimet e ashpëra për lëvizje të burgosurve nga burgu në burg, nga viti 2020, ka ofruar për klientët shërbimin e terapisë mbajtëse me metadon në <u>11</u> njësi



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								shëndetësore të burgjeve në periudhën
6. Ngritja e kapacitetit të stafit profesional në trajtimin e Viktimave të Trafikimit përdorues të substancave psiko trope/psikoaktive, dhe ata/ato të cilët janë të infektuar me sëmundje ngjitëse (AIDS, Hepatit B, C etj).	TM 1- 2022 TM 4- 2022	7.333€	7.333€	7.333€	BRK	MPMS	MPB,MSH, MPMS,QPS ,PK, PROKURO RIA,GJYK ATA. OJQ	Nurmi i trajnuar i stafit -11 staf dhe 10 puntore nga OJQ-të - Numri i trajnimeve të mbajtura Gjykata-janar -Qershor 2022, është realizuar një trajnim në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme me temën “Veprat Penale kundër narkotikëve me theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar”, më dt. 01.02.2022. Gjithsejtë pjesëmarrës



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>kanë qenë 42, prej tyre 30 Gjyqtarë dhe 12 Prokurorë Tetor-Dhjetor nuk ka pasur trajnime sa i përket narkotikëve.</p> <p>Trajnimi për “Veprat Penale kundër narkotikëve me theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar është realizuar në shkurt të vitit 2022 për të cilin besoj që ke informatat paraprake. Sidoqoftë po i konfirmoj prapë trajnimin e kanë vijuar 30 gjyqtarë (5 nga Gjykata e Apelit ndërkaq 25 nga niveli themelor) dhe 12 prokurorë, një</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

									(1) nga PRSK ndërkaq 11 të tjerë nga niveli themelor i prokurorive.
7. Rekrutimi i stafit profesional mjekësor	TM 1- 2022 TM 4- 2022	4.833€	4.833€	4.833€	BRK	MPMS	MSH		Stafi i rekrutuar Një (1) psikolog
8. Ngritja e kapaciteteve nëpër qendrat për punë sociale që merren me trajtimin e varësve të mitur nga narkotikët	TM 1- 2022 TM 4- 2022	16.666 €	16.666 €	16.666 €	BRK	MSH,MPM S	Asociacioni i Komunave të Kosoves, MPMS		Numri i trajnuar i stafit - 40 nëpunës nga QPS-të Numri i trajnimeve të mbajtura - 5 Punëtori të mbajtura
Objektivi specifik 1.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2019	Caku 2020	
Risocializimi dhe Riintegrimi	<ul style="list-style-type: none"> Jane trajnuar trajner për aktivitete rehabilituese (“Peer to peer” edukator”) për grupe të caktuara si dhe janë angazhuar ish perdorues në programe rehabilituese. 					• 30%	• 50%	• 80%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti	
		Viti 1	Viti 2	Viti 3					
1.Trajnimi i trajnerëve për aktivitete rehabilituese (“Peer to peer” edukator”) për grupet e caktuara	TM 1- 2022 TM 4- 2022	666 €	666 €	666 €	Donacion	QPS,OJQ,ON	MSH,MPMS		10 trajnerë të trajnuar K1- Labyrinth – 16 persona të trajnuar K2- Labyrinth –



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								20 persona të trajnuar K3 Labyrinth – 8 persona të trajnuar
2. Angazhimi i ish përdoruesve në programe rehabilituese.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.000 €	1.000 €	1.000 €	Donacion	OJQ,ON	MSH,MPM S	15 ish përdoruesve të angazhuar K1- Labyrinth – 10 ish-perdorues te angazhuar K2- Labyrinth – 9 ish-perdorues te angazhuar K3 Labyrinth – 16 ish-perdorues te angazhuar K4- Labyrinth – 8 ish-perdorues te angazhuar
Objektivi specifik 1.4	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2019	Caku 2020
Zvoglimi i dëmit	<ul style="list-style-type: none"> Janë trajnuar peer edukatorët, zyrtarët Policor dhe profesionistët shëndetësor në programet për zvoglim të dëmit 					<ul style="list-style-type: none"> 20% 	<ul style="list-style-type: none"> 50% 	<ul style="list-style-type: none"> 100%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Trajnimi i Peer edukatorëve, Zyrtarët Policor dhe profesionistët shëndetësorë	TM 1- 2022 TM 4- 2022	666 €	666 €	666 €	BRK	OJQ,ON	MPB,PK	Numri i edukatorëve të trajnuar



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

									Labyrinth – 5 persona
2. Zbatimi i programeve për zvogëlimin e dëmit.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	3.333€	3.333€	3.333€	BRK	MSH,OJQ	MPB,PK		Numri i programeve te zbatuara K1 Labyrinth – 5 K3 Labyrinth – 2
Objektivi specifik 1.5	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2019	Caku 2020	
Reduktimi i kërkesës	<ul style="list-style-type: none"> • Eshte krijuar baza e te dhenave per regjistrim të personave përdorues të narkotikëve • Eshte krijuar regjistri nacional i vdekshmërisë së ndërlidhur me përdorim të narkotikeve 					<ul style="list-style-type: none"> • 10% • 00% 	<ul style="list-style-type: none"> • 50% • 50% 	<ul style="list-style-type: none"> • 100% • 100% 	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti	
		Viti 1	Viti 2	Viti 3					
1 Hartimi udhëzimit administrativ për procedurat e regjistrimit dhe raportimit të përdoruesve të narkotikëve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.666 €	1.666 €	1.666 €	BRK& Donacion	MPB,MSH	OJQ, PARTNERËT NDËRKOMBËTAR	Udhëzimi administrativ i hartuar dhe miratuar	
2. Krijimi i bazës së të dhënave për regjistrim të personave përdorues të narkotikëve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	3.333€	3.333€	3.333€	BRK& Donacion	MPB,MSH	Asociacioni i Komunave te Kosoves, QPS nëper	Baza e e te dhënave e krijuar dhe e funksionalizuar	



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

							Komuna,ON	PK- Janar – Mars DHTN ka regjistruar ne databaze 126 perdorues 123 Meshkuj dhe 3 femra PK- Prill – Qershor 2021 DHTN ka regjistruar ne databaze 79 perdorues 78 Meshkuj dhe 1 femër
3. Të hartohet regjistri nacional i vdekshmërisë së ndërlidhur me përdorim të narkotikeve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.666 €	1.666 €	1.666 €	BRK & DONACION	MSH,IML, MD	MPB,PK,OJ Q	Regjistri i krijuar dhe mirëmbajtur
STRATEGJIA SHETËRORE KUNDËR NARKOTIKËVE DHE PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2022								
Objektivi Strategjik #2: REDUKTIMI I OFERTËS DHE FURNIZIMIT								
Objektivi specifik 2.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2019	Caku 2020
Parandalimi i furnizimit dhe ofertës	• Jane zbatuar plane operationale per parandalimin, prodhimin,kultivimin, shprendarjen ,furnizimin ,trafikimin e narkotikeve dhe keqperdorimit te barnave narkotike					• 50%	• 50%	• 90%
	• Eshte rritur bashkepunimi me qytetaret dhe jane shtuar veprime policore neper ambientet shkollore					• 50%	• 60%	• 100%
Aktiviteti		Kostoja totale				Inst.		Produkti



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

	Afati i zbatimit	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Burimi i financimit	udhëheqës	Inst. mbështetës	
1 Hartimi dhe zbatimi i planeve operacionale në nivel të vendit për parandalimin e prodhimit, kultivimit shpërndarjes, furnizimit, dhe trafikimit të narkotikëve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	1.000€	1.000€	1.000€	BRK	MPB,PK ,DK	AKI,IF,AK PPM,ISH, QKMK	200 plane të hartuara dhe 700 operacione të realizuara PK- Janr – Qershor 2022 DHTN ka pasur gjithsej 27 plane operative. Korrik- Shtator 2022 DHTN ka realizuar 5 plane operative të hartuara dhe 41 operacione të realizuara si dhe 99 bastisje / kontrolla Tetor- Dhjetor 4 planeve të hartuara dhe 41 operacioneve të realizuara DK- Bazuar në aktivitetet e bashkërenduara në PKK dhe vijën e gjelbër



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>janë zbuluar 6 raste me narkotik.</p> <p>Bazuar në aktivitetet e bashkërenduara në PKK dhe vijën e gjelbër janë zbuluar 8 raste me narkotik.</p> <p>Ne nje opereacion te përbashkët me Policine e Kosoves ne veri te vendit eshte zbuluar nje laborator per kultivimin e marijuanës dhe mbi 10.000 fije bimë narkotike.</p> <p>DK- Bazuar në aktivitetet e bashkërenduara në PKK dhe vijën e gjelbër janë zbuluar 6</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								raste me narkotik. K4- Bazuar në aktivitetet e bashkërenduara në PKK dhe vijën e gjelbër janë zbuluar 9 raste me narkotik.
2. Hartimi dhe zbatimi i planeve operacionale për kontrollimin e keqpërdorimit të barnave narkotike, psikotrope dhe prokusoreve	TM 1- 2022 TM 4- 2022	666 €	666 €	666 €	BRK	IF,ISH	PK,DK,AK PPM	Numri i planeve të hartuara dhe operacioneve të realizuara <u>Inspektorati Farmaceutik ne tremujorin e pare te vitit 2022</u> eshte kryer inspektim me ç’rast jane marre masa per dispenzim me



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>narkotik pa recete mjekesore dhe jo konform specifikave (tejkalim te dozes ditore gjate dispenzimit). Per produkte psikotrope jane shqiptuar gjithesej 11 gjoba kryesisht kane qene produkte te pa autorizuar per tregun e Kosoves ku ne mesin e tyre kishe edhe produkte psikotrope <u>ne tremujorin e dyte te vitit 2022</u> Per produkte psikotrope jane shqiptuar gjithesej 10 gjoba në</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>Barnatore, kryesisht kane qene produkte te pa autorizuar per tregun e Kosoves ku ne mesin e tyre kishe edhe produkte psikotrope.</p> <p>Per produkte psikotrope jane shqiptuar gjithsej 6 gjoba në Barnatore, dispensim e produkteve psikotrope pa recete mjekesore. Inspektorati Farmaceutik në tremujorin e kater K4 të vitit 2022 ka kryer këto inspektime: Për produkte psikotrope jan shqiptuar</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>gjithesëj <u>12</u> <u>gjoba në Barnatore</u>, kryesisht kanë qenë produkte të pa autorizuar për tregun e Kosovës ku në mesin e tyre kishe edhe produkte psikotrope.</p> <p>Për dispensim të produkteve psikotrope pa recetë mjekësore janë shqiptuar gjithesëj <u>4 gjoba në Barnatore</u>.</p>
3. Parandalimi i futjes së narkotikëve nëpër qendrat korrektuese.	TM 1- 2022 TM 4- 2022	666 €	666 €	666 €	BRK	SHKK	PK,AKI	50 raste të parandaluara dhe sasia e konfiskuar PK- Janar-Qershor 2022 gjithesëj kane qene 16 raste nga shërbimet



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

								<p>korrektuese te lajmëruar . Korrik- Shtator 2022 26 raste jane lajmëruar ne DHTN pranuar nga Qendrat Korrektuese Tetor- Dhjetor- 13 raste dhe 552.05 gr marihuane e konfiskuar SHKK- Raport K1 dhe K2 (6 Mujor) nga SHKK-së, të përmbledhura në Total: janë 22 raste te zbulimit dhe parandalimit .Sasia e konfiskuar e substancave te dyshuara narkotike i është dorëzuar policisë për ekzaminim dhe procedim.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

